



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.18 Regj.Them.

Datë Regj: 01.06.2021

Nr.14 Vendimi

Datë: 10.06.2021

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: Sokol IBI (*Relator*)

Gjyqtar: Asim VOKSHI (*Anëtar*)

Gjyqtare: Edlira PETRI (*Anëtare*)

Gjyqtare: Emona MUÇI (*Anëtare*)

Gjyqtare: Alma KOLGJOKA (*Anëtare*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 10.06.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.18 Regj.Them, datë 01.06.2021 që i përket:

PADITËSE:

Subjekti Zgjedhor Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, përfaqësuar me autorizimin e datës 07.05.2021 nga Z.Marash Logu.

I PADITUR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me Nr. 5707 Prot. datë 10.06.2021 nga Z. Olsi Peto.

PALË TË INTERESUARA:Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (në mungesë).

Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim me Autorizimin nr. 180 Prot. datë 27.05.2021 nga Av. Maringlen Legisi, Dhoma e Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI:

1. Kundërshtimi i vendimit nr. 89, datë 25.05.2021 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 38, të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Shpalljen e pavlefshmërisë të zgjedhjeve, për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Shkodër.
3. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Shkodër.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1, 18, 35, 42, 45 dhe 64 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenet 6, 8 dhe neni 3, Protokollin 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, nenet 136, 137, 145, 152, 153, 156, 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, nenet 14, 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, nenet 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të KQZ-së.

KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat në seancë gjyqësore, dëgjoi pretendimet e fundit të palëve, që kërkuan:

Pala paditëse, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) :

- Pranimin e padisë sipas objektit.

Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve :

- Rrëzimin e padisë të ngritur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 89, datë 25.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS).

Personi i Interesuar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) në mungesë,

Personi i Interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë :

Rrëzimin e plotë të padisë të ngritur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), si të pabazuar në ligj dhe në prova.

VËREN:

1. Pala paditëse, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi më datë 01.06.2021, duke kërkuar *“Kundërshtimin e vendimit nr.89, date 25.05.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) për rrëzimin e kërkesës ankimore Nr. 38, të subjektit zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN). Shpalljen e pavlefshmërisë të zgjedhjeve, për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore Qarku Shkodër”*.
2. Gjykimi në Kolegjin Zgjedhor u zhvillua në mungesë të personit të interesuar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (në vijim referuar si L.S.I). Përfaqësuesi i saj Av. Altin Kaziaj i paraqiti Kolegjit Zgjedhor një kërkesë me shkrim, me të cilën kërkonte shtyrjen e seancës gjyqësore të datës 10.06.2021, ora 11.00, me pretendimin se ndodhej në të njëjtën kohë në një proces tjetër gjyqësor penal në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si përfaqësues i shtetasit G.P.
3. Këtë kërkesë të përfaqësuesit të personit të interesuar LSI, Kolegji Zgjedhor e rrëzoi me vendim të ndërmjetëm gjatë gjykimit duke zhvilluar gjykimin në mungesë të personit të interesuar LSI.
4. Qënia në një proces tjetër gjyqësor e përfaqësuesit të një pale, sikurse në rastin konkret e përfaqësuesit të personit të interesuar LSI, nuk përbën në vetvete një shkak ligjor që justifikon shtyrjen e seancës gjyqësore të një procesi tjetër gjyqësor që zhvillohet në të

njëjtën kohë civil, penal, administrativ apo në Kolegjin Zgjedhor sikurse në rastin konkret.

5. Është e drejta e çdo pale të marrë pjesë ose jo në një proces gjyqësor. Përfaqësimi i një pale në gjykim nga një avokat është përsëri një e drejtë ligjore e kësaj pale. Përfaqësuesi i një pale, sikurse në rastin konkret përfaqësuesi i personit të interesuar LSI, ka të drejtë të zgjedhë nëse do të marrë pjesë në këtë proces gjyqësor apo në një proces tjetër gjyqësor që zhvillohet në të njëjtën kohë, ku ai përfaqëson interesat e një klienti tjetër. Kjo është një çështje që lidhet me mënyrën e organizimit të punës të përfaqësuesit të personit të interesuar LSI dhe nuk përbën pengesë ligjore për zhvillimin e këtij gjykimi në Kolegjin Zgjedhor dhe shkak ligjor për shtyrjen e këtij gjykimi. Nga ana tjetër është detyrim i palëve ndërgjyqëse të marrin masa për të mos u bërë pengesë për zhvillimin e procesit gjyqësor.
6. Data dhe ora e zhvillimit të seancës gjyqësore 10.06.2021 ora 11.00 është caktuar nga Kolegji Zgjedhor sipas nenit 154/2, pika “c” të K.Zgjedhor, duke marrë parasysh që vendimi përfundimtar për këtë çështje duhet të jepet nga Kolegji Zgjedhor brenda afatit të shkurtër kohor që vendos ligji 10 ditë nga depozitimi i kësaj padie. Ky afat i shkurtër ligjor për gjykimin e këtyre kategorive të çështjeve në Kolegjin Zgjedhor, tregon rëndësinë që ka ky proces gjyqësor jo vetëm për palët pjesëmarrëse por për gjithë publikun (sidomos zgjedhësit dhe të zgjedhurit). Në të tilla rrethana është në interesin e palëve pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor të marrin masa të përfaqësohen në këtë proces dhe të sigurojnë që përfaqësuesit e tyre të jenë prezent në gjykim. Personi i interesuar në rastin në shqyrtim LSI, sikurse secila prej palëve pjesëmarrëse në këtë gjykim i kishte të gjitha mundësitë të zgjedhë një përfaqësues për ta përfaqësuar atë, si dhe të caktojë një përfaqësues tjetër kur përfaqësuesi i parë për një arsye apo për një tjetër nuk paraqitet në gjykim. Përfaqësuesi i personit të interesuar LSI ka zgjedhur të mos marrë pjesë në këtë gjykim pa pasur shkaqe ligjore (për shkak se dëshiron apo zgjedh të marrë pjesë si përfaqësues i një tjetër personi në një tjetër proces gjyqësor). Për pasojë Kolegji Zgjedhor ka vlerësuar se personi i interesuar LSI ka zgjedhur të mos marrë pjesë në këtë proces gjyqësor dhe për këtë arsye vendosi zhvillimin e gjykimit në mungesë të kësaj pale.

I. FAKTET E CËSHTJES:

1. Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, caktoi datën 25 Prill 2021, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

2. Në datën 25.04.2021, në 12 Zonat Zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Zona Zgjedhore Qarku Shkodër ka 8 (tetë) Zona të Administrimit Zgjedhor (në vijim ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 01, ZAZ nr. 02, ZAZ nr. 03, ZAZ nr. 04, ZAZ nr. 05, ZAZ nr. 06, ZAZ nr. 07 dhe ZAZ nr. 08.

3. Me vendimin nr. 342, datë 04.05.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) vendosi miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Shkodër në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Në përfundim të procesit të numërimit të votave për subjektet zgjedhore, u konstatuan 107.781 fletë të vlefshme votimi dhe 6114 fletë votimi të pavlefshme.

4. Sipas tabelës përmbledhëse rezulton se subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN) ka siguruar 47205 fletë të vlefshme votimi, të ndara sipas zonave zgjedhore si vijon:

- ZAZ nr. 01, fletë votimi të vlefshme 7090
- ZAZ nr. 02, fletë votimi të vlefshme 11473
- ZAZ nr. 03, fletë votimi të vlefshme 6996
- ZAZ nr. 04, fletë votimi të vlefshme 5938
- ZAZ nr. 05, fletë votimi të vlefshme 5486
- ZAZ nr. 06, fletë votimi të vlefshme 6376
- ZAZ nr. 07, fletë votimi të vlefshme 2214
- ZAZ nr. 08, fletë votimi të vlefshme 1632

5. Kundër vendimit nr. 342, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) ka paraqitur ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN).

6. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve me vendimin nr.89, datë 25.05.2021 ka vendosur:

“1. Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 38, datë 09.05.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD - AN);

2. Lënien në fuqi të vendimit nr. Nr. 342, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.”

7. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ndër të tjera ka arsyetuar, në lidhje me kërkimin e ankuesve për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë qark:

“Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cenimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu, shitblerja e votës që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh dhe që këtë herë u cilësua si “problem i përhapur”, nuk u vëzhgua prej tyre në masë kritike....

...Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjete ligjor është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv

dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që cenon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka cenuar ajo procesin zgjedhor.

8.Subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), pasi është njohur me vendimin e K.A.S i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me padinë objekt gjykimi.

9.Pala paditëse, Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim (PD – AN), në kërkesë padi dhe gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, pretendoi se:

- Vendimi i KAS është i cenueshëm, ai është marrë në shkelje të ligjit procedural dhe ligjit material, si dhe nuk është kryer një hetim i plotë e i gjithanshëm.
- Në lidhje me ligjin procedural: Subjekti zgjedhor PD – AN gjatë hetimit administrativ ka vendosur në dispozicion të KAS çdo provë të siguruar nga vetë ajo, më qëllim identifikimin e të gjitha aspekteve të paligjshmërisë që karakterizuan procesin zgjedhor të 25 prillit.
- Në kushtet kur një pjesë e provave ka qenë e pamundur të sigurohet nga subjekti, ky i fundit i ka kërkuar KAS-it që ti drejtohet organeve të administratës shtetërore, për të vënë në dispozicion informacione, dokumente dhe çdo provë tjetër që kërkohet ose çmohet e nevojshme për hetimin administrativ.
- Kërkesa e subjektit është refuzuar nga KAS, kjo në shkelje flagrante të nenit 136, pika 1, shkronja “c” dhe nenit 137 të Kodit Zgjedhor.
- Në lidhje me themelin e pretendimeve për pavlefshmëri:
- Në lidhje me pavlefshmërinë e zgjedhjeve: Kodi Zgjedhor ka përcaktuar në mënyrë të detajuar cilat janë rastet kur zgjedhjet shpallen të pavlefshme, cili është organi kompetent dhe pasojat që sjell një vendim i tillë, sipas përcaktimeve të nenit 160 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa në rast të marrjes së një vendimi për pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një zonë zgjedhore, neni 161, pika 1 parashikon se KQZ-ja, eventualisht Kolegji Zgjedhor urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore.
- Në rastin konkret, subjekti zgjedhor PD-AN ka parashtruar një numër të madh shkeljesh të Kushtetutës, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kodit të Praktikës së Mirë për

Çështjet Zgjedhore dhe Kodit Zgjedhor, të cilat në tërësinë e tyre cenojnë rëndë procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikojnë drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Tërësia e këtyre shkeljeve krijon bindjen e plotë bazuar në fakte dhe prova të pakundërshtueshme, si dhe Kodin Zgjedhor, për shpalljen e pavlefshme dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Zonën Zgjedhore Shkodër.

- Mohimi i të drejtës për të votuar i emigrantëve: Deri në datën 19 prill 2021, nuk ka pasur asnjë ndalim që emigrantët shqiptarë, të hynin në Shqipëri dhe të vendoseshin në karantinë. Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë, vetëm 1 javë para zgjedhjeve, nxori një vendim që detyronte emigrantët që vinin nga Greqia apo Maqedonia e Veriut të karantinoheshin detyrimisht për një periudhë 2-javore. Ky vendim pengonte efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi, për të ushtruar të drejtën e votës, në mënyrë diskriminuuese.
- Zgjedhësit, që ishin të infektuar me COVID-19 dhe që ndodheshin në karantinë, qenë të detyruar të respektonin rregullat e izolimit, duke u cenuar “*de facto*” e drejta e tyre për të votuar.
- E drejta e çdo qytetari shqiptar për të votuar është e sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht është një nga të drejtat themelore e parashikuar në nenin 3, Protokoli 1 të KEDNj.
- Ndërsa në nenin 24 dhe 25 të Kodit Zgjedhor, është parashikuar shprehimisht e drejta e votimit për emigrantët shqiptarë në vendin e tyre të rezidencës, mundësi kjo e cila nuk u është dhënë, duke mohuar një nga të drejtat e tyre themelore.
- Blerja e votës dhe përdorimi i personave me rekorde të tmerrshme kriminale: Në qarkun Shkodër është konstatuar shitblerja e votave dhe shkeljet e tjera flagrante. Ndërtimi i një skeme kriminale, e shtrirë në të gjithë Qarkun e Shkodrës për blerjen e votës, nëpërmjet përfshirjes të personave me rekorde kriminale, përbën shkelje flagrante të Kodit Zgjedhor, duke cenuar rëndë procesin zgjedhor, e për rrjedhojë duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Ky ndikim është veçanërisht domethënës për Qarkun e Shkodrës ku diferenca ndërmjet PSD dhe PD për mandatin e deputetit është vetëm 2074 vota.
- Shitblerja e votës është një ndër problematikat kryesore të konstatuara edhe në Deklaratën e Gjetjeve dhe Rekomandimeve Paraprake të OSBE/ODIHR. Partia Demokratike nëpërmjet strukturave të saj në terren ka evidentuar dhe faktuar raste të shumta flagrante të shitblerjes së votës. Për të gjitha këto raste, PD ka depozituar 50 kallëzime

penale në SPAK, ndër të cilat 30 kanë të bëjnë me raste masive të shitblerjes së votës dhe 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve për shkelje të tjera. Në rastin e qarkut Shkodër, Partia Demokratike ka depozituar një kallëzim në SPAK për 28 zyrtarë të lartë të pushtetit qendror dhe vendor dhe persona të lidhur me ta, me rekorde të tmerrshme kriminale, të përfshirë drejtpërdrejtë në blerjen e votave në favor të PS.

- Janë evidentuar shitblerje votash me 100 Euro, dhënie e pagave shtesë nga drejtuesi politik i Partisë Socialiste për Qarkun Shkodër dhe njëkohësisht Drejtor i Përgjithshëm i OSHEE, i cili ka dhënë një pagë shpërblim për 13 mijë punonjës të OSHEE, etj. Këto veprime janë të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 3 i Vendimit Nr. 9/2020 të KQZ-së
- Blerja e votës nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera: Shitblerja e votës u krye nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera të cilat përbënin problem në procesin zgjedhor duke devijuar vullnetin e qytetarëve. Qeveria nëpërmjet akteve nënligjore ka miratuar vendime qeverie nëpërmjet të cilave është mundësuar dhënia e një shpërblimi në fund vit, për mjekët dhe punonjësit e Policisë së Shtetit. Është vendosur të ndryshohet struktura dhe niveli i pagave për punonjësit e stafit mjekësor, punonjësve të tjerë me arsim të lartë dhe punonjësit e stafit teknik të shkencave mjekësore në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë, Njësisë Mjekësore Ushtarake në Spitalin Universitar të Traumës, në strukturat e Forcave të Armatosura dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
- Investimet publike: Shteti ka vendosur investimet publike në funksion të PS-së për zgjedhjet e 25 Prill 2021. Në vitin 2020, pra një vit para zgjedhjeve, pati një rritje të lartë të kontratave publike, qoftë në numër, ashtu edhe në vlerën e tyre. Janë prokuruar rreth 878 kontrata publike me vlerë 505 milionë Euro, ndërkohë që mesatarja e vlerës së kontratave publike të 5 viteve të fundit është në vlerën 116 milionë Euro.
- Neni 3 i Vendimit Nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, ndalon mbështetjen dhe promovimin, në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve, të projekteve ose investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut. Janë evidentuar së paku 781 raste në të gjithë vendin, 16 prej të cilave në qarkun e Shkodrës, ku kryeministri, ministrat dhe deputetët promovuan projekte apo investime publike me qëllime të qarta elektorale.

- Intimidimi i administratës shtetërore për të mbështetur PS: Gjatë fushatës u konstatuan raste të shumta, të cilat janë denoncuar vazhdimisht nga PD, sesi të gjitha nivelet e administratës vendore dhe qendrore ishin përfshirë në fushatë duke mbështetur publikisht kandidatët e PS-së.
- Veç kësaj punësimi në sektorin publik u rrit ndjeshëm në periudhën parazgjedhore. Sipas INSTAT në 2020 punësimi në sektorin publik u rrit me 6% pra me 10.572 persona. Ndërkohë, më 24 Dhjetor, qeveria autorizoi edhe krijimin e 2.472 pozicione të reja në administratën publike. Qartësisht, punësimet në administratën publike në periudhën zgjedhore, kur nuk diktohen nga nevoja të ngutshme, kanë për qëllim të përkthehen në mbështetje dhe vota për partinë në pushtet. Subjekti Zgjedhor PD –AN në argumentet e saj i është referuar dhe statistikave të publikuar nga Ministria e Financës.
- Këto veprime janë shkelje të rënda ligjore, të cilat kanë si qëllim përfitim politik duke devijuar vullnetin e votuesve. Konstatimet e sipërcituara janë evidentuar edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.
- Dhënia e lejeve të legalizimit/ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore: Deputetë të ndryshëm të Partisë Socialiste kanë shpërndarë leje legalizimi në kundërshtim me përcaktimin e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së. Kjo kategori, nuk e ka në kompetencë të shpërndajë një dokument të tillë nga zyra e ASHK-së. Këto veprime qartazi tregojnë se si Partia Socialiste e ka vendosur shtetin në dispozicion të qëllimeve të saj elektorale. Ka raste të përsëritura, për të cilat Partia Demokratike disponon foto dhe video, ku kandidatë për deputetë shpërndanë leje legalizimi në periudhën e ndaluar nga Kodi Zgjedhor, me qëllim të pastër elektorale. Në 20 Prill, u publikua një audio përgjimit i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, gjatë një takimi me vartësit e tij, ky i fundit u *kërkon* “...që mos procedojnë më tej me rreth 100.000 kërkesa për leje legalizimi të banesave private, të cilat me siguri do të refuzohen duke sjellë prishjen e tyre. Kjo pasi, refuzimi i dhënies së lejeve të legalizimit do të sillte që këta persona të votonin për opozitën..”
- Sa më lart, paditësi PD –AN, konkludon se, është e qartë se parimi i barazisë ndërmjet palëve garuese në zgjedhje u cenua rëndë pasi shteti dhe partia në pushtet (PS) u shkrinë në një. Një konstatim i tillë gjendet dhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR). Ky përdorim masiv i burimeve shtetërore, përveçse një veprimtari e paligjshme, e cila duhet hetuar dhe dënuar nga organet e drejtësisë, është në shkelje flagrante të neneve 78, 91, 92 të Kodit Zgjedhor dhe neneve 3 dhe 6 të Vendimit Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ-së,

çka ka cenuar rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në vullnetin e zgjedhësve, rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe ndarjen e mandateve në Qarkun e Shkodër.

- Përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale: Shteti vendosi të dhënat personale në dispozicion të serverave të PS në Tiranë dhe Shkodër. Në datën 11 prill, media publikoi një bazë të dhënash të 910.000 zgjedhësve që përdorte Partia Socialiste në Tiranë, duke bërë publike të dhëna personale si numri i ID, vendi i banimit, numri i telefonit dhe bindja politike e shprehur në zgjedhjet e kaluara dhe projeksionet për zgjedhjet e 2021. Këto të dhëna janë marrë nga të dhëna shtetërore që qytetarët i kanë vënë në dispozicion në portalin e-albania për të marrë shërbime gjatë pandemisë, apo në institucione të tjera shtetërore për të marrë shërbime nga administrata. Rrjedhja e të dhënave personale sensitive, duke përfshirë edhe preferencat politike të zgjedhësve përbën shqetësim serioz dhe i bën zgjedhësit vulnerabël. Skandali me të dhënat personale u evidentua edhe në Raportin Paraprak të OSBE/ODIHR.
- Mbledhja, përpunimi, përdorimi dhe publikimi i të dhënave personale pa pasur miratimin me shkrim të mbajtësit të të dhënave është shkelje e rëndë e nenit 35 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 8 të Konventës Evropiane dhe neneve 6 dhe 7 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Duke qenë se shteti dhe partia ishin të pajisur me informacion për secilin zgjedhës, përfshirë edhe bindjet e tyre politike, kjo i bëri më vulnerabël përballë pushtetit dhe më lehtësisht viktimë e presioneve apo mjeteve të tjera të kundërligjshme për të ndaluar të shprehin vullnetin e tyre lirisht, duke përdorur mekanizma të ndryshëm pengues.
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor: Në datën 30.07.2020, Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit 115/2020, miratoi nismën e PS-së për disa ndryshime kushtetuese të cilat në thelb sanksiononin: (i) heqjen e koalicioneve parazgjedhore; (ii) sistemin me votim preferencial për 2/3 e kandidatëve; dhe (iii) vendosjen e një pragu kombëtar. Në vijim të ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në datën 05.10.2020 disa ndryshime në Kodin Zgjedhor, të cilat kishin të bënin me: (i) ulja nga 3% në 1% e pragut kombëtar; (ii) renditja e kandidatëve që përfitojnë mandat ndryshon nëse kandidati ka marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara; (iii) ri-renditjen e listës fituese sipas kandidatëve që kanë

fituar numër votash më të madh se herësi; dhe (iv) kryetari i partisë ka të drejtë të kandidojë deri në katër qarqe.

- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor nga Partia Socialiste, duke shkelur marrëveshjen konsensuale u evidentuan si problematika edhe nga Misioni i OSBE/ODIHR.
- Numri i madh i fletëve të votimit të pavlefshme: Numri i votave të pavlefshme ishte 83.026, ose 5% e numrit total të votuesve dhe vetëm për Qarkun e Shkodrës ishin 6.114 vota të pavlefshme ose 5.3%. Ky fakt është ndikuar nga përmbajtja e fletës së votimit me numra dhe jo me emrat e kandidatëve, duke krijuar konfuzion ditën e zgjedhjeve.
- Miratimi i një flete votimi në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga neni 98 i Kodit Zgjedhor dhe pika 27 e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, solli një numër tejet të lartë të fletëve të votimit, të cilat nëse do të ishin përkthyer në mandate mund të ndryshonin rezultatin nga 5 – 8 mandate në të gjithë Shqipërinë. Këto mandate mund të sillnin jo vetëm ndryshimin e rezultatit në qarqe të caktuara, ku diferenca ndërmjet palëve është e ngushtë, por edhe në rang kombëtar, kur dihet se partia e parë sipas rezultateve paraprake ka vetëm katër mandate më shumë se shumica e kërkuar për formimin e qeverisë.
- Diskriminimi i kandidatëve gjatë procesit zgjedhor: Ligji u lejon vetëm kryetarëve të partive, por asnjë kandidat tjetër që të kandidojë deri në 4 zona zgjedhore, ndërkohë që kandidatët e tjerë mund të kandidojnë vetëm në një zonë, gjë që përbën shkelje të së drejtës së kandidimit në kushte të barabarta, ky fakt, përbën një diskriminim në të drejtën për t'u zgjedhur, në kuptim të neneve 18 dhe 45 të Kushtetutës.
- Votimi më shumë se një herë, votimi për të tretët apo votimi familjar: Një nga risitë e zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 25 prill 2021 ishte identifikimi elektronik i zgjedhësve. Futja e këtij mekanizmi të ri në Kodin Zgjedhor ishte kërkuar me forcë nga PD dhe kishte qenë pjesë e konsensusit të arritur ndërmjet palëve për ndryshimet e Kodit Zgjedhor në Korrik 2020. Nëpërmjet identifikimit elektronik synohej të eliminohej votimi më shumë se një herë, në të njëjtën qendër votimi apo qendra të tjera, votimi për të tretët apo votimi familjar. Por, gjithsesi ajo që mbetet problematike është fakti se nga informacionet e marra në terren nga strukturat e Partisë Demokratike rezultoi se këto fenomene nuk janë shmangur.
- Nga subjekti zgjedhor PD –AN jepen detaje mbi rastet konkrete. Është konstatuar se persona të ndryshëm kanë votuar më shumë se një herë, qoftë për të tretët apo familjarë të tyre, duke shkelur kështu drejtpërdrejtë Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, ekzistenca e këtij

problemi u pranua edhe nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili në datën 6 maj njoftoi fillimin e procesit të kryqëzimit të dhënave për të konstatuar rastet e votimit më shumë se një herë në një qendër votimi apo qendra të ndryshme. Nga të dhënat e administruara nga KAS nga kryqëzimi i të dhënave të pajisjeve PEI, rezultoi se shenjat e gishtërinjve të 17 personave janë përdorur për identifikimin e 34 zgjedhësve, çka potencialisht, siç u pranua edhe nga ana e Nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, do të thotë se 17 persona kanë votuar 34 herë ose 2 vota secili.

- Si përfundim, subjekti zgjedhor PD – AN, vlerëson se, në tërësinë e tyre këto shkelje të ligjit shqiptar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, cenuan rëndë procesin zgjedhor, duke ndikuar drejtpërdrejtë në ndarjen e mandateve. Në këto kushte, është e qartë se vendimet e marra në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, cenuan rëndë procesin zgjedhor, duke diktuar një rezultat në shpërputhje me vullnetin e zgjedhësve, e për rrjedhojë edhe ndarjen e mandateve, dhe për rrjedhojë në kuptim të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, ky proces zgjedhor në Qarkun Shkodër duhet të shpallet i pavlefshëm dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në këtë qark.
- Me qëllim garantimin e të drejtës së palës ankuese për një proces të rregullt ligjor, PD-AN parashtron kërkesat e saj për marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, në përputhje me nenet 136 dhe 137 të Kodit Zgjedhor, dhe nenet 223 dhe 224 të Kodit të Procedurës Civile.

10. Pala e paditur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, gjatë gjykimit pretendoi se, vendimi nr. Nr. 89, datë 25.05.2021 i KAS, është i bazuara në ligj dhe në prova dhe si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

- Subjekti zgjedhor koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, pretendon se ka pasur shitblerje votash, nëpërmjet përfshirjes së njerëzve me rekorde kriminale në fushatë zgjedhore si dhe nëpërmjet dhënies së bonuseve dhe përfitimeve të tjera. KAS vlerësoi se provat e paraqitura prej këtij subjekti ankues dhe të pranuarat për shqyrtim nga KAS-i nuk faktojnë sa raste shitblerje vote, sa raste lejesh legalizimi, sa raste punësimi, sa raste mohimi të së drejtës për votim për emigrantët, sa raste votimi të shumëfishtë, ka pasur në Qarkun e Shkodrës. Po kështu, ato nuk faktojnë se sa kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës nga secili prej këtyre fenomeneve, apo edhe i formave të tjera të përdorimit të

burimeve shtetërore, i dhënies së ndihmave apo i ushtrimit të presionit mbi zgjedhësit. Subjekti ankues nuk kishte siguruar asnjë provë nga institucione të tjera shtetërore, por kërkoi që KQZ-ja ti merrte ato.

- U pretendua nga subjekti ankues se, nga Partia Socialiste kishte keqpërdorim të të dhënave personale rreth të ashtuquajturit “skandali i patronazhistëve”, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre. KAS u shpreh se përdorimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale rregullohet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale. Rrethanat e lidhura me skandalin e patronazhistëve provojnë shkallën e ulët të respektimit të rregullave të vendosura nga ky ligj në Shqipëri. Provat e paraqitura në këtë kontekst provojnë sensibilitetin ndaj ngjarjes, por jo ndikimin e saj tek votuesit. Subjekti ankues nuk solli prova se publikimi mund të kishte intimiduar zgjedhësit dhe t’i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit.
- Subjektet ankuese ngritën pretendime kundrejt urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një “vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës”. Urdhri i sipërcituar është motivuar me nevojën për të dominuar përhapjen e epidemisë Covid19, në kushtet e “kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse”. Vet izolimi i personave që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë është një masë që është marrë në mënyrë të përsëritur që nga koha e nisjes së pandemisë dhe ka qenë e lidhur me statistikat e sëmundshmërisë dhe pritshmëritë nga ngjarje të caktuara. Mbyllja, izolimi apo vet izolimi kanë qenë masa dominuese edhe në rastet e festave të tjera zyrtare, publike ose fetare. Në kohën që u mor kjo masë Republika e Greqisë ka pasur në fuqi izolimin 14 ditor dhe numrin e kufizuar të hyrjeve për personat që hynin në territorin grek nga Shqipëria. Më vonë kjo masë u shndërrua në izolim 7 ditor. Shqipëria e mbajti në këmbë këtë masë deri më datën 3 maj 2021, d.m.th. deri pas festës. Urdhri nr. 219, datë 19.04.2021 është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti zgjedhor LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrit nuk mund të vihet në

diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

- Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit. Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur. Kriteri ligjor për matjen e ndikimit përcaktohet nga neni 161 i Kodit dhe është gjithmonë numerik.
- Arsyeimi i paditësit Partia Demokratike konsiston në argumentimin e veprimit kumulativ të një serie shkeljesh dhe parregullsish të supozuara ose të provuara të cilat kanë degraduar zgjedhjet në atë masë, sa që rezultati i tyre është jo legjitim dhe zgjedhjet duhet të shpallen të pavlefshme në të gjithë zonën zgjedhore.

11. Personi i Interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, gjatë gjykimit, nëpërmjet përfaqësuesve të tij, pretendoi se:

- Padia e ngritur kundër vendimit të KAS Nr. 89, datë 25.05.2021 është e pabazuar në ligj dhe në prova dhe duhet të rrëzohet nga Kolegji Zgjedhor. Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ka vlerësuar drejtë dhe saktë të gjitha pretendimet duke interpretuar me përpikmëri ligjin zgjedhor mbi pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre.
- Tashmë është bërë e qartë se paditësi, subjekti zgjedhor PD-AN, për të gjitha zonat zgjedhore në Republikën e Shqipërisë përdor të njëjtat pretendime mbi të njëjtat fakte ose ngjarje dhe gjithmonë me mungesë të theksuar të argumentimit të shkeljes dhe lidhjes shkak-pasojë.
- Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit. Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që cenojnë

rëndë procesin zgjedhor”. Shkelje që cenojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur.

- Në interpretim të nenit 125/4 dhe 160 të Kodit Zgjedhor, në çdo rast kërkesa për pavlefshmëri duhet të përmbajë të nominuar qendrën apo qendrat e votimit, për të cilat kërkohet pavlefshmëria e rezultatit zgjedhor të miratuar. Secila qendër votimi ka specifikat e veta apo shkaqe të ndryshme, të veçanta ose të përbashkëta për konstatimin e elementëve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe kjo gjithmonë në varësi të bazës faktike të pretendimit të parashtruar nga paditësi. Edhe nga përmbajtja e padisë nuk rezulton që të jenë dhënë sqarime apo interpretime sipas të cilave kërkohet pavlefshmëria e rezultatit në një apo disa qendra votimi.
- Nga ana e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë janë pretenduar fakte që lidhen me shitblerjen e votës, mohim të së drejtës për të votuar, raste të votimit të shumëfishtë, raste punësimi, dhënie ndihmash etj, por asnjëherë të provuara se sa kanë ndikuar në pengimin/largimin e zgjedhësve nga votimi, në detyrimin e votuesve që të votojnë në një mënyrë të caktuar, apo tjetërsimin e votës.
- Pala paditëse, duhet të provojë qartësisht se ka pasur shkelje të ligjit, të cilat kanë ndodhur në qendrat e votimit dhe se ekziston lidhja shkakësore ndërmjet shkeljes së ligjit dhe pasojës, pra cënimit të rëndë të procesit zgjedhor.
- Në asnjë moment nuk pretendohet pavlefshmëri në një apo disa qendra votimi konkrete të qarkut të Shkodrës, pra nuk përcaktohet asnjë qendër votimi me shkelje konkrete ligjore. Kërkesat detyrimisht duhet të jenë të arsyetuara, specifike dhe të identifikuara qartë.
- Po ashtu ky subjekt ka pretenduar shkelje të ligjit zgjedhor që lidhen me ushtrimin e veprimtarive të ndaluara si miratimi i V.K.M apo ndryshimeve të V.K.M, por që nuk janë ankimuar asnjëherë prej tij në KQZ.
- Përcaktimi i Urdhrit nr. 219, datë 19.04.2021 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" si një *“vendim që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës”*. Ky urdhër është kontestuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti ankues LSI. Subjekti ankues PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye,

ligjshmëria e urdhrimit nuk mund të vihet në diskutim. Efektet e një urdhri të ligjshëm nuk mund të formojnë shkelje. Pa shkelje nuk ka pavlefshmëri.

- Lidhur me pretendimin tjetër se në ditën e zgjedhjeve, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 ishte rreth 23.000, statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre janë qytetarë të qarkut Shkodër, e as faktin se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës.
- Një pretendim i veçantë ka lidhje me numrin anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme. Në zonën zgjedhore Qarku Shkodër numri i këtyre votave është 6114 ose 5.37% e numrit total të votave, por ky numër nuk mund të konsiderohet anomalisht i lartë, sepse mungon baza krahasuese, fakt ky i konstatuar drejt nga KAS.
- Në tërësinë e tyre, të gjitha faktet apo ngjarjet e pretenduara prej paditësit përveçse janë të pa provueshme për kundërligjshmërinë e tyre, nuk referojnë në të paktën një qendër votimi në Qarkun Shkodër dhe nuk parashtrohet asnjë arsyetim i detajuar sipas kërkesave të ligjit.
- Edhe sikur të kishte patur shkelje ligji, këto shkelje duhet që të kenë ndodhur në qendrën e votimit dhe jo në vende të tjera, si edhe të kenë ndikuar në shpërndarjen e mandateve.
- Sipas përcaktimeve të nenit 160, pika 4 të Kodit Zgjedhor, kuptohet, se shkeljet përveçse duhet të kenë ndodhur në ambientet e qendrës së votimit, duhet që të jetë mbajtur edhe një raport nga K.Z.A.Z ose informacioni t'i jetë referuar K.Z.A.Z me shkrim nga qendra e votimit.
- K.Z.A.Z në veprimtarinë e vet ligjore, të gjithë informacionin mbi zhvillimin e votimeve në qendrat e votimit e ka në mënyrë të shkruar dhe të komunikuar po nga këto qendra.
- Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre mjeti ligjor është gjoba administrative, masat disiplinore, ndjekja penale etj, por për asnjërën prej tyre, kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të kërkuar pavlefshmëri.
- Për sa kohë, në asnjë moment nuk provohet sipas ligjit pavlefshmëria e zgjedhjeve në një apo disa qendra e votimi, edhe kërkimi tjetër për përsëritjen e tyre sipas nenit 161 të Kodit Zgjedhor mbetet i pa bazuar në ligj dhe në prova.
- Si përfundim, kërkohet rrëzimi i padisë si i pabazuar në ligj dhe në prova.

12. Personi i Interesuar, Lëvizja Socialiste për Integrim, sikurse parashtrohet më sipër në këtë vendim, nuk u paraqit në gjykim, duke e lënë atë në mungesë.

II. DISPOZITA LIGJORE TË ZBATUESHME

Kodi Zgjedhor

Neni 160

Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit

1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se:

a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;

b) kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose

c) votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

2. Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kërkojnë në KQZ shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi.

3. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre.

4. Shqyrtimi i kërkesave bëhet sipas procedurave të përcaktuara në pjesën X të këtij Kodi. KQZ-ja, në marrjen e vendimit për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, mund konsultohet me KZAZ-në përkatëse. Në arsyetimin e vendimit të KQZ-së duhet të përshkruhet shkaku ligjor, rastet e vërtetuara të shkeljeve dhe arsyetimi i detajuar për pasojën e tyre.

Neni 161

Përsëritja e zgjedhjeve

1. Pas përfundimit të procesit të ankimit, jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore, KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjektit, shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë zonën zgjedhore, kur pavlefshmëria e shpallur në një ose

disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

2. Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend kur numri i zgjedhëse, që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përlllogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore, të bërë sipas nenit 162 të këtij Kodi.

III. INTERPRETIMI I DISPOZITAVE LIGJORE TË ZBATUESHME.

1. Në nenin 160 të Kodit Zgjedhor parashikohen rastet kur zgjedhjet në një ose disa qendra votimi duhet të shpallen të pavlefshme nga ana e KQZ kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore.

2. Në këtë dispozitë ligjore parashikohen tre raste kur zgjedhjet në një ose disa qendra votimi duhet të shpallen të pavlefshme.

3. Rasti i parë i parashikuar nga neni 160/1, pika ``a`` e Kodit Zgjedhor, lidhet me shkeljet e ligjit që provohet se kanë ndodhur në zgjedhjet në një ose më shumë qendra votimi, të cilat provohet se kanë sjellë si pasojë cenimin e rëndë të procesit zgjedhor në këtë apo këto qendra votimi ku kanë ndodhur këto shkelje të ligjit. Cenimi i rëndë i procesit zgjedhor në një apo më shumë qendra votimi ndodh në kushtet kur si pasojë e shkeljes së ligjit, zgjedhësit janë penguar ose larguar në masë nga votimi në një apo disa qendra votimi, ose që zgjedhësit janë detyruar të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre në një ose disa qendra votimi, ose kur si pasojë e këtyre shkeljeve të ligjit është tjetërsuar në masë vota e hedhur nga zgjedhësit në një apo disa qendra votimi.

4. Në këtë aspekt është e rëndësishme të provohet si shkelja e ligjit e ndodhur, qendra apo qendrat e votimit ku ajo ka ndodhur, ashtu edhe pasojat e rënda të ardhura që lidhen me cenimin e rëndë të procesit zgjedhor në një apo disa qendra votimi konkrete.

5. Në nenin 160/1 pika ``a`` të Kodit Zgjedhor parashikohet se zgjedhjet në një ose disa qendra votimi janë të pavlefshme edhe kur kanë ndodhur një tërësi shkeljesh të ligjit në një ose disa

qendra votimi konkrete, që kanë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.

6. Në këtë rast është e rëndësishme të provohet si shkeljet e ligjit të ndodhura në një ose disa qendra votimi, por edhe fakti që këto shkelje kanë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.

7. Kjo do të thotë se jo çdo shkelje ligjore që provohet se ka ndodhur në procesin zgjedhor pas sjell pavlefshmëri të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi. Shkelja apo shkeljet e ligjit duhet të provohet se kanë sjellë si pasojë cenimin e rëndë të procesit zgjedhor në një apo disa qendra votimi konkrete ose që ka ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.

8. Në nenin 160/1, pika ``b`` të Kodit Zgjedhor parashikohet si shkak për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi rasti kur, kanë ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim. Kjo lidhet me fatkeqësitë natyrorë të ndodhura në territorin e një ose disa qendrave të votimit të tilla si psh tërmeti, përmytja etj, ku si pasojë e këtyre fatkeqësive natyrore është penguar masivisht pjesëmarrja e zgjedhësve në një ose disa qendra votimi ku ka ndodhur fatkeqësia natyrore.

9. Në nenin 160/1, pika ``c`` të Kodit Zgjedhor parashikohet si shkak për të shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo më shumë qendra votimi, rasti kur votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se pesë orë.

10. Në nenin 161 të Kodit Zgjedhor parashikohet përsëritja e zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Kjo ndodh kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

11. Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend kur numri i zgjedhësve, që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme, është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse, mbi bazën e përlllogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore, të bërë sipas nenit 162 të këtij Kodi.

IV. VLERËSIMI I KOLEGJIT ZGJEDHOR

1. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, pasi analizoi dispozitat ligjore, administroi provat shkresore dhe dëgjo i pretendimet e palëve, çmon se padia e palës paditëse Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, është e pambështetur në prova dhe në ligj dhe duhet të rrëzohet.

2. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se nga pala paditëse nuk janë provuar shkelje konkrete të ndodhura në një ose disa qendra votimi konkrete, ashtu siç e përcakton ligji, por pretendohet në mënyrë të përgjithshme për gjithë Zonën Zgjedhore Qarku Shkodër shkelje të cilat sipas palës paditëse i bëjnë të pavlefshme zgjedhjet në gjithë Zonën Zgjedhore Qarku Shkodër.

3. Provat e paraqitura nga pala paditëse nuk provojnë se sa raste shitblerje votash kanë ndodhur në Zonën Zgjedhore Qarku Shkodër, sa raste dhënie lejesh legalizimi kanë ndodhur, sa raste punësimi kanë ndodhur në periudhën zgjedhore në kohën e ndaluar, sa raste mohimi të së drejtës për të votuar për emigrantët kanë ndodhur, apo sa raste votimi të shumëfishtë ka pasur në Qarkun e Shkodrës. Gjithashtu nuk shpjegohet dhe nuk provohet nga ana e palës paditëse se në cilat qendra votimi konkrete të Qarkut Shkodër kanë ndodhur këto shkelje, me qëllim që Kolegji Zgjedhor të vlerësojë më pas nëse këto shkelje të ligjit kanë cenuar apo jo rëndë procesin zgjedhor ose këto shkelje të ligjit kanë cenuar apo jo procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në Zonën Zgjedhore Qarku Shkodër.

4. Vetëm nëse do të provoheshin këto rrethana gjykata do të vendoste deklarin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi ku kanë ndodhur këto shkelje dhe më pas do të mund të vlerësonte nëse plotësoheshin apo jo kushtet ligjore për përsëritjen e zgjedhjeve në të gjithë Zonën Zgjedhore Qarku Shkodër, kjo në varësi të faktit nëse pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi, sipas nenit 160 të këtij Kodi, ndikon apo jo në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore Qarku Shkodër ose në shkallë vendi.

5. Kallëzimet penale të paraqitura si provë nga pala paditëse, nuk janë prova që vërtetojnë ekzistencën e shkeljeve të kallëzuara nga kallëzimtari. Këto kallëzime penale provojnë ekzistencën e pretendimeve të kallëzimit mbi ekzistencën e fakteve për një ose disa vepra penale të kryera. Nëse këto vepra penale janë kryer apo jo, përbën lëndë për procedimin penal. Deri në këtë moment, nuk ka asnjë rezultat lidhur me fatin e kallëzimeve penale të depozituara, pra nuk ka asnjë përfundim mbi ekzistencën e fakteve të kallëzuara.

6. Në lidhje me pretendimin e palëve ndërgjyqëse, përsa i përket Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1076 datë 24.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 555 datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e ministrisë së shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”, të ndryshuar, konstatohet se ky vendim ka dalë brenda periudhës së ndalimit dhe sjell rritje pagash për kategori të caktuara punonjësish publikë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 18.12.2020 “Për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar” është miratuar përpara fillimit të periudhës së ndalimit dhe për këtë arsye nuk përbën shkelje. Po kështu miratimi i VKM nr. 1102, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021”, nuk përbën shkelje, sepse ai vendim përcakton procedurat dhe kriteret bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural për vitin 2021 dhe nuk lidhet me dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë.

7. Shkelja e kryer me nxjerrjen e VKM nr. 1076, datë 24.12.2020, përbën kundërvajtje administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor. Vendimi nr. 1151 datë 24.12.2021 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e Qeverisjes Qendrore” nuk është vendim për marrje në punë, por është një akt kuadër që përcakton numrin e personave që do të punësohen në institucionet përkatëse. Pala paditëse nuk provoi, nëse sipas kësaj VKM-je janë marrë apo jo efektivisht persona në punë dhe nëse janë marrë, sa prej tyre janë me banim në Qarkun e Shkodrës dhe në cilën masë ndikon kjo shkelje ligjore e pretenduar në secilën qendër votimi të Qarkut Shkodër, me qëllim për të hetuar nëse kjo shkelje e pretenduar e deformon apo jo në masë vullnetin e zgjedhësve të një apo disa qendrave të votimit në Qarkun Shkodër me qëllim që zgjedhjet të shpallen të pavlefshme në një apo disa qendra votimi të Qarkut Shkodër.

8. Përsa i përket pretendimit të palëve ndërgjyqëse rreth debatit mediatik të të ashtuquajturit “skandali i patronazhistëve”, i cili ka lidhje me një bazë të dhënash prej rreth 900 mijë zgjedhësish, ku ishin fiksuar, ndër të tjera, dhe preferencat e aluduara politike të tyre, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon se gjatë gjykimit nuk u provua fakti se publikimi ka ndikuar ose mund

të kishte ndikuar në vullnetin e zgjedhësve për të zgjedhur apo t'i kishte mbajtur ata larg nga procesi i votimit. Nuk u paraqitën prova nga pala paditëse për të provuar faktin se si ndikon kjo shkelje e pretenduar e ligjit në vullnetin e zgjedhësve të Zonës Zgjedhore Qarku Shkodër, tek cilat qendra votimi të Zonës Zgjedhore Qarku Shkodër dhe në cilën masë ndikon kjo shkelje ligjore e pretenduar në secilën qendër votimi me qëllim për të hetuar nëse kjo shkelje e pretenduar e deformon apo jo në masë vullnetin e zgjedhësve të një apo disa qendrave të votimit në Qarkun Shkodër.

9. Përsa i përket pretendimit të palëve paditëse në lidhje me mohimin e mundësisë së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit, që të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se Komisionit Rregullator i është lënë kompetenca e posaçme që të vendosë “zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin”. Në zgjedhjet e 25 prillit 2021 Komisioni Rregullator nuk e shfrytëzoi këtë kompetencë, duke mos e ligjëruar mundësinë e kësaj kategorie zgjedhësish të votonin në distancë. Për shkak të mos aplikimit të votimit nga jashtë vendit, e drejta e tyre e votimit do të realizohej në këto zgjedhjeve vetëm nëpërmjet paraqitjes në qendrën e tyre të votimit. Ky modalitet votimi është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Pamundësia e votimit në distancë në këto zgjedhje për shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit nuk formon shkelje, duke mos sjellë as pavlefshmëri.

10. Përsa i përket pretendimit të palëve paditëse se, urdhri nr. 219, datë 19.04.2021 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia" është një akt nënligjor që pengoi efektivisht 500 mijë emigrantë shqiptarë që jetojnë në Greqi për të ushtruar të drejtën e votës, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor çmon se është një pretendim i pambështetur në prova dhe në ligj. Urdhri i sipërcituar është motivuar me nevojën për të penguar përhapjen e epidemisë Covid19, në kushtet e “kontakteve më intensive në popullatë deri në përfundim të festës dhe veprimtarive fetare të lidhura me pashkët ortodokse”. Urdhri nr. 219, datë 19.04.2021 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është kundërshtuar pa sukses në rrugë ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit nga ana e personit të interesuar LSI. Pala paditëse PD nuk ka shfrytëzuar mjetet ligjore për kontestimin e tij. Për këtë arsye, ligjshmëria e urdhrin nuk mund të vihet në diskutim. Kolegji Zgjedhor konstaton se nxjerrja e këtij akti nënligjor, sjell si pasojë kufizimin e ligjshëm të së drejtës për të

zgjedhur të shtetasve shqiptarë me të drejtë vote që në kohën e hyrjes në fuqi të këtij akti nënligjor gjendeshin në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut apo Greqisë.

11.Përsa i përket pretendimit të palës paditëse se, u është mohuar e drejta e zgjedhjes personave të infektuar me “COVID 19”, të cilët kanë qenë të detyruar të qëndrojnë të izoluar dhe se, sipas Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar me COVID-19 në të gjithë vendin ka qenë 23.000 vetë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konstaton se statistika e ofruar nuk saktëson se sa prej tyre janë qytetarë me banim në Qarkun e Shkodrës, e as faktin se sa prej tyre kanë qenë zgjedhës. Kolegji Zgjedhor vlerëson se nuk rezulton e provuar që numri i personave të infektuar me COVID 19, që janë banues me të drejtë vote në Qarkun e Shkodrës (e që janë karantinuar për shkak se janë të infektuar sa më sipër), të jetë aq i lartë sa të ketë sjellë si pasojë pengimin në mënyrë masive të pjesëmarrjes së zgjedhësve në votim në një apo disa qendra votimi apo në të gjithë qendrat e votimit të Qarkut Shkodër, si kusht ligjor për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose disa qendra votimi në Qarkun e Shkodrës.

12.Lidhur me pretendimin e palës paditëse se ka pasur një numër anomalisht të lartë të fletëve të votimit të pavlefshme, për shkak të konfigurimit jo të qartë dhe të kuptueshëm të fletës së votimit për zgjedhësit, Kolegji Zgjedhor konstaton se ky pretendim është i pabazuar në prova dhe në ligj. Provat e paraqitura në gjykim nuk provojnë faktin se ka pasur një lidhje shkakësore midis konfigurimit të fletës së votimit dhe numrit të votave të pavlefshme që në zonën zgjedhore Qarku Shkodër kanë qenë 6114 vota të pavlefshme ose 5.37% e numrit total të votave. Ligjshmëria e konfigurimit të fletës së votimit dhe qartësia e saj për zgjedhësit nuk mund të vihet në diskutim, pasi për të u shpreh Kolegji Zgjedhor Gjyqësor me vendim të formës së prerë.

13. Lidhur me pretendimin e palës paditëse se kryetareve të partive i`u dha e drejta të kandidojnë në katër zona zgjedhore dhe kjo përbën një diskriminim në raport me kandidatët e tjerë të cilët kishin të drejtën e kandidimit në vetëm një zonë zgjedhore, Kolegji Zgjedhor vlerëson se ky diskriminim është bërë me ligj dhe se nuk përbën shkak ligjor për shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një apo disa qendra votimi të Qarkut Shkodër dhe shkak ligjor për përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Shkodrës sikurse pretendon dhe kërkon pala paditëse.

Listat e subjekteve politike dhe regjistrimi i tyre për procesin zgjedhor i përkasin një faze më të hershme, që tashmë ka përfunduar, duke përfshirë edhe mundësinë e kontrollit gjyqësor nëpërmjet procesit të ankimimeve. Asnjë pretendim i tillë nuk rezulton të jetë referuar nëpërmjet

një ankimi, ndaj rezervat e palës paditëse për ligjin zgjedhor, nuk mund të zgjidhen nëpërmjet këtij procesi, por vetëm nëpërmjet ndërhyrjes së ligjvënësit për të ardhmen.

14. Pretendimi i palës paditëse në padi se, ka pasur blerje të votës dhe përdorim të personave me precedentë të tmerrshëm kriminalë, të cilët kanë ushtruar ndikimin e tyre të kundërligjshëm mbi vullnetin e zgjedhësve në Qarkun Shkodër, është një pretendim i cili nuk bazohet në provat e shqyrtuara në gjykim.

Provat e paraqitura në gjykim nga pala paditëse nuk provojnë faktet e sipërpërmendura dhe pretendimet e mësipërme të palës paditëse, se ka pasur blerje votash në Qarkun Shkodër, apo se persona me precedentë penalë kanë ushtruar ndikimin e tyre të kundërligjshëm mbi vullnetin e zgjedhësve të Zonës Zgjedhore Qarku Shkodër.

Kallëzimet penale të bëra në prokurori nga ana e palës paditëse për individë të caktuar ku është pretenduar se kanë kryer blerje votash dhe vepra të tjera penale që kanë ndikuar në procesin e votimit, nuk provojnë faktin e kryerjes së këtyre veprave penale, përse kohë procedimi penal nuk ka dhënë ende një rezultat.

15. Pretendimi i palës paditëse se shteti u vendos në shërbim të partisë duke përdorur në mënyrë të paligjshme burime shtetërore për devijimin e vullnetit të zgjedhësve, është një pretendim që nuk bazohet në provat e shqyrtuara në gjykim.

Po kështu i pabazuar në provat e shqyrtuara në gjykim është edhe pretendimi tjetër i palës paditëse se individë me rekorde kriminale kanë përfituar nga prokurimet publike në këmbim të mbështetjes politike në zgjedhje.

Provat e paraqitura në gjykim nga pala paditëse nuk provojnë pretendimet e tyre të sipërpërmendura.

Personat që përmend në padi pala paditëse duke pretenduar se kanë përfituar nga prokurimet publike, nuk provohet që kanë përfituar nga këto prokurime publike në këmbim të ushtrimit të ndikimit të tyre mbi votën e zgjedhësve në Qarkun e Shkodrës. Po kështu nuk provohet që këta persona të kenë ushtruar këtë ndikim të paligjshëm mbi zgjedhës të një qendre të caktuar votimi apo të disa qendrave të caktuara të votimit në Qarkun Shkodër.

16. Lidhur me pretendimin e palës paditëse se, shteti vendosi investimet publike në funksion të PS për zgjedhjet për propagandë politike, se në 24 raste deputetë të PS promovuan investime publike me qëllime elektorale, Kolegji Zgjedhor vlerëson se lidhur me këto pretendime pala

paditëse nuk paraqiti në gjykim prova për të provuar faktin juridik se si dhe në çfarë mase kanë ndikuar në zgjedhjet në një apo disa qendra votimi në Qarkun e Shkodrës këto shkelje të pretenduara prej palës paditëse, me qëllim që Kolegji Zgjedhor të përcaktojë nëse ato janë apo jo të asaj rëndësie që parashikon ligji që passjellin pavlefshmërinë e zgjedhjeve në një apo disa qendra votimi në Qarkun e Shkodrës dhe më pas për të vlerësuar nëse ishin apo jo kushtet ligjore për përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun Shkodër.

17. Pretendimi i palës paditëse në padi se, është intimiduar administrata shtetërore për të mbështetur në zgjedhje Partinë Socialiste, është një pretendim që nuk bazohet në provat e shqyrtuara në gjykim.

18. Pala paditëse Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim kërkoi nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor që të merrte në cilësinë e provës 19 informacione specifike nga institucione të ndryshme që veprojnë në territor. Kolegji, pasi dëgjoi edhe mendimin e palëve të tjera ndërgjyqëse, vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë.

Së pari: Pala paditëse nuk provoi para Kolegjit Zgjedhor faktin që ka qenë e pamundur që këto informacione të siguroheshin paraprakisht prej saj dhe arsyet përse nuk ka qenë e mundur sigurimi i tyre, sikurse kërkon shkronja “c” e pikës 1 të nenit 136 të Kodit Zgjedhor. Ky është një kusht ligjor që duhet të demonstrohet se është plotësuar në momentin që paraqitet kërkesa për marrjen e provës, përndryshe dispozita nuk do kërkonte që kërkuesi të paraqiste njëkohësisht me kërkesën edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i provave.

Së dyti: Pala paditëse në kuptim të nenit 223 dhe 224 të K.Pr.Civile kishte detyrimin të tregonte me hollësi para Kolegjit Zgjedhor llojin e dokumentit apo dokumenteve që kërkon të merren tek këto institucione, duke identifikuar ato dokumente me numër dhe datë, të parashtronte në kërkesën e saj arsyet që e bëjnë të besueshme para Kolegjit Zgjedhor se këto dokumente ekzistojnë si të tillë dhe vendin ku ato ndodhen.

Në rastin konkret pala paditëse në kërkesën e saj për marrjen e provave dhe informacioneve pranë organeve të administratës publike nuk tregoi me hollësi para Kolegjit Zgjedhor llojin e dokumentit apo dokumenteve që kërkon të merret duke mos identifikuar këto dokumente me numër dhe datë si prova, për të bërë të besueshme para Kolegjit Zgjedhor se këto prova ekzistojnë në realitet si të tilla, vendin ku ato ndodhen dhe faktet që do të provojnë me këto prova. Pala paditëse nuk referoi tek asnjë dokument konkret zyrtar i këtyre institucioneve ku mund të gjendeshin informacionet e kërkuara.

Në të tilla rrethana Kolegji Zgjedhor nuk u bind si për llojin e aktit apo dokumentit që kërkohet nga pala paditëse të merrej nga këto institucione, për identifikimin e këtyre akteve dhe dokumenteve sa më sipër, për ekzistencën e tyre në realitet dhe vendin ku ndodhen. Për rrjedhojë nuk krijohet bindja se ky informacion mbi akte dhe dokumente ekziston në këto institucione si i tillë apo këto dokumente e akte ekzistojnë realisht si të tillë me qëllim për të verifikuar nëse lidhen apo jo me nevojat e këtij gjykimi.

19. Për këto arsye vendimi Nr.89, datë 25.05.2021 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve është një vendim i ligjshëm dhe nuk janë kushtet për shfuqizimin e tij.

20. Kërkimi në padi i palës paditëse për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për Qarkun Shkodër të zhvilluara në datën 25.04.2021, si dhe kërkimi për përsëritjen e këtyre zgjedhjeve në këtë qark, janë kërkime të pabazuara në prova dhe në ligj dhe padia e paditësit duhet rrëzuar nga Kolegji Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i përditësuar,

V E N D O S I

- Rrëzimin e padisë të palës paditëse Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim, si te pambështetur në prova dhe në ligj.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 10.06.2021.

GJYQTARE
Edlira PETRI

GJYQTAR
Asim VOKSHI

GJYQTAR
Sokol IBI

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTARE
Emona MUÇI